

Pyetjet 2

1.Pasqyrat financiare sigurojne informatat ne lidhje me?

Pasurine, Detyrimet, Kapitalin, Te ardhurat dhe Shpenzimet, Rrjedhen e parase se kompanise.

2.Pasqyra e Bilancit te Gjendjes duhet te perfshije se paku keto zera?

Patundshmerite, impiantet dhe pajimet, Pasurine e paprekshme, Stoqet, Llogarite e arketueshme (bleresit), Keshi (parate e gatshme), Investimet (depozitat e afatizuara), Llogarite e arketueshme (furnitoret), Detyrimet tatimore, Provizionet, Interesin nga detyrimet jokorente, Detyrimet ndaj kredive, Kapitalin e Emetuar dhe Rezervat, etj.

3.Pasqyra e te ardhurave duhet te perfshije se paku keto zera?

Te Hyrat nga Veprimtaria e Firmes (p.sh te hyrat nga shitja e mallrave), Kategorite themelore te shpenzimeve nga Veprimtaria, Fitimi (humbja) nga Veprimtaria, Shpenzimet financiare , Shpenzimet e Tatimit ne Fitim, Te hyrat Tjera, Zerat e Jashtzakonshem, Fitimi (humbja) neto per periudhen raportuese.

4.Ne pasuri korente bejne pjese?

Parate e Gatshme, Depozitat ne Banka, Llogarite e Arketueshme (bleresit), Stoqet, Avanset, etj.

5.Ne obligimet jokorente bejne pjese?

Huatë afatgjata, detyrimet ndaj lizingut kapital, detyrimet afatgjata, investimet afatgjata (emitimi-shitja e obligacioneve) etj.

6.Rrjedha e parave te gatshme nga aktiviteti afariste perfshine?

Arketimet ne para te gatshme nga shitja e mallrave dhe sherbimeve
Arketimet ne para te gatshme nga tarifat, komisionet dhe tarifat tjera,
Pagesat me para te gatshme per blerjen e mallrave dhe sherbimeve
Pagesat me para te gatshme per te punesuarit
Pagesat ne para te gatshme per dhe refundimet e tatimeve nga te hyrat.

7.Rrjedha e parave te gatshme nga aktiviteti financues?

Arketimet ne para te gatshme nga emetimi i aksioneve ose i instrumenteve te tjera financiare.

Arketimet ne para te gatshme nga lejimi i kredive, obligacioneve, pengjeve dhe huamarrjeve te tjera afatshkurta ose afatgjata.



Pagesat me para te gatshme huamarresit qe zvoglon shumen e detyrimeve te papaguara te huase financiare
Pagesat me para te gatshme per pronaret e nderrmarjes (pagesat e dividendes)
Ripagimi ne para te gatshme te borxhit (huase).

8.Lidhjet ne mes te kontabilitetit financiare, kontabilietit menaxherial dhe sistemit informative te menaxhmentit?

Kontabilitetin financiare dhe ate menaxherial i lidhe pergjegjesia per ti permblodhur dhe raportuar informatat per palet e interesuara. Kontabiliteti financiar i krijon raportet financiare per shfrytezuesit e jashtem siq jane bankat, aksionaret, investitorët, etj, kontabilietit menaxherial ekziston kryesisht per te miren e menaxhmentit brenda kompanise. Sistemi informative i menaxhmentit (SIM) ben pergatitjen e informatave te veqanta dhe te vlefshme te manxhmentit brenda kompanise.

9.Mjedisi qe operon ne konkurrence globale ka krijuar nje kerkese per shqyrtime te shenimeve jofinanciare me qellim te?

Permirsimit te kualitetit te prodhimeve apo sherbimeve, te rritjes se efikasitetit duke shkurtuar kohen per ti krijuar dhe shperndare prodhimet apo sherbimet, per ti realizuar kenaqesite e konsumatorit dhe per ti ulur shpenzimet.

10.Kriteret per shpenzimet e stoqeve, nje shpenzimet nuk duhet ti ngarkoi stoqet (gjysmeproduketet dhe produktet e gatshme) vetem nese I ploteson keto kritere?

Nese nuk ka fare dyshim se jane shkaktuar gjate procesit te prodhimit dhe mund te bashkangjiten si veprim i drejteperdrejte pune.

E ka mundesine qe ne rastet kur ato shkaktohen nga nga veprimtarite operative dhe jo-operative te ndahen ne pjesen dirkte dhe indirekte, p.sh uji, rryma, etj.

Nese nje shpenzim nuk I permbushe kriteret paraprake, duhet te regjistrohet si shpenzim gjate periudhes.

11.Shpenzimet e materialit indirekt jane?

Jane te gjitha ato shpenzime me pak te rendesishme te cilat perdoren per nevoja te ndryshme si p.sh ne prodhimin e automjeteve, bulonave, ne ndertimtari, gozhda, etj. Materiali indirekt eshte pjese e shpenzimeve te pergjithshme te fabrikes.

12.Renditja e kostos ne ate te prodhimit dhe periodike behet per shume arsye?

Te mund te percaktohet kostoja e prodhimit per njesi ashtu qe te vlersohen stoqet dhe qmimi shites tem und te vertetohet,

Te mund te paraqiten shpenzimet e prodhimit ne pasqyren e te ardhurave,

Te shqyrtohen shpenzimet per qellime kontrolli.



13.Shpenzimet qe shtojne ne vlere kundrejt atyre qe nuk shtojne?

Shpenzimet qe nuk shtojne ne vlere jane shpenzime te veprimtarive operative te cilat e rrisin shpenzimin e prodhimit por jo edhe vleren e produktit ne treg. Shpenzimet te cilat e shtojne vleren jane shpenzime te veprimtarive operative te cilat e rritin vleren ne treg te projekteve dhe sherbimeve, zhvlersimi i makines eshte shpenzim i cili shton ne vlere.

14.Shperndarja e shpenzimeve te prodhimit?

Te gjitha shpenzimet e prodhimit mund te shperndahen neper sektore te kompanise, por edhe ne njesi te prodhimit. Shume nga shpenzimet mund te jene indirekte. Metoda per shperndarjen e shpenzimit varet nga shqyrtimi i shpenzimeve te caktuara per te cilat synohet. Nje shpenzim mund te jete shpenzim direkt per piksynime te pergjithshme (sektori) por ne te njeten kohe shpenzim indirekt per piksynime te vogla (produkti).